



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 119 prot.

Tiranë, më 28.2. 2022

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Lënda: Mbi raportet e monitorimit për 12-mujorin e vitit 2021

RELACION

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë për vitin 2021. Zbatimi i këtij buxheti është bazuar në parimin e ligjshmërisë, economicitetit, efikasitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve buxhetore, si dhe mbështetet në drejtimit kryesore të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Në vijim paraqitet, në mënyrë të përmbledhur, realizimi i fondeve buxhetore për këtë periudhë, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor 2021	Buxheti vjetor i rishikuar 2021	Realizimi vjetor 2021	Realizimi në %
Shpenzime korente	70,350	70,350	68,776	97,8 %
Shpenzime kapitale	4,000	-	-	-
TOTALI	74,350	70,350	68,776	97,8 %

Fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit 2021, në shpenzime korente dhe shpenzime kapitale, në total 74,350 mijë lekë, janë rishikuar gjatë vitit nëpërmjet rialokimeve brenda shpenzimeve korente, si dhe me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 3.12.2021. Vlera totale e buxhetit arriti, në fund të vitit 2021, në 70,350 mijë lekë. Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për vitin 2021 është në nivelin 97.8% ose 3.3% më e lartë se në vitin 2020.

Në një vështrim të përgjithshëm, buxheti total i miratuar për vitin 2021 ishte i mjaftueshëm për mbulimin e nevojave për shpenzimet korente. I ndarë sipas zërave buxhetorë, buxheti i miratuar në shpenzime personeli, sikurse dhe me vitet e kaluara, nuk i plotësonte nevojat në fushën e pagave për vitin 2021, siç është argumentuar në të gjitha komunikimet me Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në dokumentin e hartimit të Projektbuxhetit afatmesëm 2021-2023. Nga ana tjetër, buxheti i miratuar në shpenzime operative e tejkalohte nevojën e institucionit dhe, për këtë arsye, gjatë vitit, me miratimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, u kryen rialokime mes artikujve buxhetorë, brenda shpenzimeve korente, sikurse do të shpjegohet në vijim.


Po kështu, shpenzimet kapitale e tejkalonin kërkesën e institucionit dhe, për këtë arsye, në muajin dhjetor të vitit 2021, u pakësuan me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 3.12.2021.

Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për këtë periudhë, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet si në vijim:

Realizimi i buxhetit sipas artikujve ekonomikë

Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	57,000	65,800	65,744	99.9%
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime, dhe fondi i veçantë	13,350	4,550	3,032	66.6%
231	Shpenzime kapitale	4,000	0	0	0%
	TOTALI	74,350	70,350	68,776	97,8%



1. Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”, buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2021 për këtë zë është 57,000 mijë lekë, buxhet i cili nuk mbulonte nevojat e institucionit për të gjithë vitin, për të përmbushur detyrimet ligjore në fushën e pagave, sipas kërkesave të hartuara në dokumentin e Projektbuxhetit për vitin 2021. Kjo është reflektuar edhe në detajimin mujor të buxhetit të vitit 2021, ku shpenzimet e personelit për muajin dhjetor ishin 0 lekë, si dhe është theksuar në raportin e monitorimit të çdo 4-mujori. Për këtë arsye është kërkuar transferimi i fondeve të lira nga shpenzimet operative në shpenzime për paga, të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në muajt prill dhe gusht, dhe buxheti i pagave pas rialokimeve ka arritur në vlerën 65,800 mijë lekë.

Buxheti i rishikuar i vitit 2021 pas rialokimeve ka mbuluar shpenzimet e personelit për 30 punonjës, mbështetur në Vendimin e Kuvendit nr.102/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Kuvendit nr. 94/2017”, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, si dhe për 2 punonjësit me kontratë të përkohshme.

Performanca e realizimit të tij për vitin 2021, siç paraqitet në formë tabelare dhe grafike, është në nivelin 99.9%.

2. Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull, për vitin 2021, është 13,200 mijë lekë, buxhet i cili, siç u theksua më lart, e tejkalonte kërkesën e institucionit, reflektuar kjo në Projektbuxhet, detajimin e buxhetit vjetor, si dhe në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike. Me transferimin e fondeve, buxheti në shpenzime operative u pakësua me 8,800 mijë lekë, duke reduktuar pothuajse të gjitha shpenzimet e planifikuara për udhëtime, një pjesë të shpenzimeve telefonike, të gjithë fondin e pashpërndarë, i cili nuk ishte përfshirë për t’u prokuruar që në fillim të vitit, si dhe fondet e lira pas përfundimit të procedurave të prokurimit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve. Pas pakësimit të tij dhe transferimit në fondin e pagave, ky buxhet arriti në vlerën 4,400 mijë lekë.

Performanca e realizimit të buxhetit të artikullit: “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, për vitin 2021, është në nivelin 66.6%.

Gjatë vitit 2021 janë kryer disa procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël, për shërbime dezinfektimi, materiale pastrimi, licencimi i *firewall*-it, blerje tonera dhe *drum*-e, ujë i pijshëm etj., si dhe procedura të thjeshtuara, blerje: kancelari, shpenzime larje automjeti, mirëmbajtje pajisje teknike, elektrike etj.

Gjithashtu janë kryer shpenzime nga buxheti dhe janë lidhur kontrata për parkim automjeti, telefoni celularë, si dhe shpenzime të zakonshme, shpenzime për energji, ujë, postë, taksat e Bashkisë etj.

Theksojmë se, me miratimin e ligjit për fiskalizimin, që nga 1 janari i vitit 2021, në 4-mujorin e parë të vitit, u ngadalësuan procedurat për blerje mallrash dhe shërbime, për shkak se shumë furnitorë nuk lëshonin faturën e fiskalizuar. Po kështu, ndryshimet në legjislacionin e prokurimit publik, të pashoqëruara me aktet nënligjore me rregullat e reja të prokurimit, shkaktuan vonesa, paqartësi dhe shtyrjen e disa procedurave të prokurimit, të planifikuara, situatë e cila u përmirësua në vijim në 4-mujorin e dytë pas miratimit të këtyre rregullave.

Ndërkohë, një pjesë e shpenzimeve të planifikuara, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të realizoheshin në kushtet e kufizimit të lëvizjeve, për arsye të pandemisë, si shpenzime udhëtimi e dieta dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare. Këto fonde të papërdorura u pakësuan dhe, së bashku me fondin e pashpërndarë, u transferuan në shpenzime personeli.

Analitikisht, shpenzimet operative janë realizuar si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Në mijë lekë	
		602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	1,082	602
2	Shërbime nga të tretë (energji, ujë, postë, telefon, parkim etj.)	2,178	1,836
	Materiale dhe shërbime speciale	200	105
3	Shpenzime transporti + udhëtimi	360	197
4	Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme	480	194
5	Shpenzime të tjera speciale	100	68
	TOTALI	4,400	3,002

3. Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”, buxheti i miratuar për këtë artikull për vitin 2021 është 4,000 mijë lekë, ndërkohë që buxheti i kërkuar nga institucioni për investime është në shumën prej 1,000 mijë lekë, paraqitur kjo në dokumentin e Projektbuxhetit afatmesëm, si dhe theksuar në komunikimet e mëtejshme gjatë vitit 2021, me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në fillim të vitit, institucioni ka përfshirë në Regjistrin e Parashikimit të Procedurave të Prokurimit Publik vetëm fondin e kërkuar, të parashikuar për t’u përdorur për shtimin e raftëve në zyrën e Protokoll/Arkivit dhe pajisje të tjera të nevojshme për Njësinë Ligjore. Ky buxhet nuk është realizuar në periudhën e parë të vitit, siç u përmend më lart, për shkak të paqartësive

në fushën e prokurimit publik, në mungesë të akteve nënligjore, dhe në vijim kushtëzuar nga situata në lidhje me përfundimin e mandatit të institucionit, duke marrë parasysh dhe jetëgjatësinë e aseteve. Në dhjetor të vitit 2021, buxheti në shpenzime kapitale u rishikua me Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 34, datë 3.12.2021, duke u pakësuar në vlerë totale.

Në përfundim, vlerësojmë se buxheti i vitit 2021 është zbatuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2021, duke arritur një performancë në kënaqshme të realizimit të tyre, në të gjithë zërat e shpenzimeve, si dhe plotësimin e nevojave të domosdoshme për ecurinë e aktivitetit institucional.

Nëpunës Zbatues

Adelina Kastrati



Nëpunës Autorizues



Alketa Çeli



ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Komisioneret Publike				Kodi i Grupit		63	
Programe		Shpenzimet e Institucionit							
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	(2) PBA Viti 2021	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 12 mujore /progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
0001	Programi 03360	63,387	75,800	74,350	70,350	70,350	68,776	-1,574	
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		63,387	75,800	74,350	70,350	70,350	68,776	-1,574	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit					-				
Totali		63,387	75,800	74,350	70,350	70,350	68,776	-1,574	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alkeja Çeli
	Firma			Firma	
	Data	25.2.2022		Data	25.2.2022

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke


Emri i Grupit		Komisionerët Publikë					Kodi i Grupit	63
Programi		Veprimtaria e Komisionerit Publik					Kodi i Programit	03360
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	PBA Plan 2021	Buxheti Vjetor Viti Plan Fillestar viti korrent 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plani i Periudhes 12 muajore /progresiv	Fakti i Periudhes/progresiv	Diferenca
600	Paga	54,495	59,700	51,500	59,280	59,280	59,279	-1
601	Sigurime Shoqërore	5,902	6,100	5,500	6,520	6,520	6,465	-55
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,371	9,000	13,200	4,400	4,400	3,002	-1,398
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja							0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	40		150	150	150	30	-120
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	62,808	74,800	70,350	70,350	70,350	68,776	-1,574
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	579	1,000	4,000	0	0	0	0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	579	1,000	4,000	0	0	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	579	1,000	4,000	0	0	0	0
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti						0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		63,387	75,800	74,350	70,350	70,350	68,776	-1,574


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	25.2.2022		Data	25.2.2022

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

Emri i Grupit	Komisionerët Publikë	63
Programi	Vepërtaria e Komisionerit Publik	3360

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Njësia matëse	I			II			III			IV			Luhatjet në Koston për Njësi			Komente
			Sasia Faktike (sipas vitit 2020)	Shpenzimet (sipas vitit 2020)	Kosto për Njësi (sipas vitit 2020)	Sasia (sipas planit të vitit 2021)	Shpenzimet (sipas planit të vitit 2021)	Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2021)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit 2021)	Shpenzimet (sipas planit të rishikuar të vitit 2021)	Kosto për Njësi (sipas planit të rishikuar të vitit 2021)	Sasia Faktike për 12 muajt e vitit 2021	Shpenzimet Faktike për 12 muajt e vitit 2021	Kosto për Njësi për 12 muajt e vitit 2021	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	
Produkti 1	Numer Çështjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisionerët Publikë brenda afateve ligjore	nr. Çështjesh	103	62,808	610	140	70,350	503	140	70,350	503	171	68,776	402	-34%	-20%	-20%
Produkti 2	Pajisje komp/mobile/pajisje zyre	sete pune	5	579	116	9	4,000	444	0	0	#DIV/0!	0	0	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
Totali				63,387	726	149	74,350	947	140	70,350	#DIV/0!	171	68,776	#DIV/0!				0



Nepunësi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati
	Firma	
	Data	25.2.2022

Kordinatori i GMS/Nepunësi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma	
	Data	25.2.2022

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikave se programit"

Periudha e Raportimit: 12 mujori 2021

Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit:						Komente
Qellimi 1	Procesi i Rivleresimit te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise ka per qellim garantimin e e funksionimit te shtetit te se drejtes, pavaresine e sistemit te drejtesise si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi	Veprimtaria e komisionerit Publik						
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2020	Niveli i planifikuar ne vitin 2021	Niveli i rishikuar per 12 mujorin e vitit 2021	Niveli faktik per 12 mujorin e vitit 2021	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te rregullt ligjor, transparences dhe frymes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera."							
	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	A	Shqyrtim i vendimeve te njoftuara nga KPK	103	140	140	171	122%

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	25.2.2022		Data	25.2.2022

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2021	Realizimi Progresiv nga fillimi i vitit 2021	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progresiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	-				-				
M630013	Pajisje kompjuterike	-				-				
TOTALI		-			-	-	-	-	-	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	25.2.2022		Data	25.2.2022